



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ / 2020

V E N D I M

Nr. 179, Datë 18 / 12 / 2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr. 125, datë 30.10.2020, e F. K, kundër Shoqërisë “Emante” sh.p.k, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “shtatzënisë” dhe “barrë lindjes”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, F. K, shprehet se ka qenë në marrëdhënie pune me Shoqërinë “Emante” sh.p.k, për periudhën nga data 12.01.2015 deri më datë 14.09.2020, dhe se, marrëdhënia e punës mes saj dhe punëdhënësit ndër vite ka qenë shumë normale e korrekte nga të dyja palët dhe asnjëherë nuk ka qenë subjekt i masave disiplinore për shkak të mospërmbushjes së detyrave funksionale. Ankuesja parashtrohet se, detyrat dhe përgjegjësitë e marra ndër vite, kanë ardhur në rritje, kjo dhe si rrjedhojë e përgjegjëshmërisë së saj në kryerjen e punës, respektit ndaj punëdhënësit dhe rigorizitetit në respektim të detyrave të përcaktuara. Së fundmi, ankuesja shprehet se ka mbajtur detyrën e financieres pranë kësaj Shoqërie.

Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës, F. K, për periudhën tetor 2019- 14.09.2020 ka qenë me raport barrë lindjeje dhe pas konsumimit të lejes së lindjes, me datë 14.09.2020 është rikthyer sërish në punë. Ankuesja ka pretenduar se, pas paraqitjes në ambjentet e Shoqërisë për të rifilluar punë, nuk është lejuar nga ana e punëdhënësit të rikthehet në detyrën e saj, pasi i është komunikuar verbalisht se vendi i saj i mëparshëm i punës ishte i zënë dhe nuk kishte vend pune për të, duke e diskriminuar atë në të drejtën për punësim, pikërisht për

¹Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

shkak barrë lindjes, pasi gjatë raportit mjekësor të “lejes së lindjes” ajo ishte zëvendësuar nga një punonjëse tjetër.

Në përfundim subjekti ankues ka kërkuar shprehimisht: *“Shpërblim të dëmit të shkaktuar, duke detyruar Shoqërinë “Emante” sh.p.k të paguajë pagat si pasojë e mosrespektimit të afatit të njoftimit, procedurës së zgjidhjes së Kontratës së Punës, vjetërsisë në punë dhe lejes së pamarrë, ose në të kundërt dënimin e Shoqërisë me gjobë”*.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimoreose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Pas analizimit paraprak të ankesës sipërcituar, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonin kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 1542 prot., datë 10.11.2020 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues Shoqërisë “Emante” sh.p.k, lidhur me pretendimet e ankueses.

- Nëpërmjet shkresës së datës 24.11.2020 Shoqëria “Emante” sh.p.k, ka informuar Komisionerin se:

“Përsa i përket punëmarrëses F. K, në asnjë moment nuk është diskriminuar nga ana e Shoqërisë, përkundrazi ka qenë ajo vetë që nuk ka respektuar marrëdhënien me punëdhënësin duke mos respektuar afatet e kthimit në punë pas përfundimit të lejes së lindjes”.

Shoqëria ka cituar në vijim të përgjigjes se: *“Rikthimi i saj në punë do të ishte për një vend paralel/ekuivalent. Edhe pse ajo u paraqit me vonesë në ambjentet e punës, pas lejes së lindjes i është ofruar i njëjti pozicion pune paralel/ekuivalent si financiere dhe me të njëjtën pagë. Por, F. K krijoi një marrëdhënie jo korrekte duke bllokuar komunikimin sidomos me Administratoren e Shoqërisë dhe me koleget e tjera, duke mos na njoftuar për vendimin e saj nëse do ta vazhonte marrëdhënien e punës me Shoqërinë tonë”*.

Në vijim, Shoqëria i është drejtuar znj.K më datë 21.09.2020 duke i kërkuar që të paraqitet në ambjentet e Shoqërisë për të diskutuar mbi vazhdimin e marrëdhënies së punës.

Më datë 24.09.2020 ankuesja ka depozituar pranë Shoqërisë dy njoftime të datave 14.09.2020 dhe 24.09.2020, në të cilat pretendohet prej saj se nuk është pranuar në ambjentet e punës dhe se i ishte komunikuar verbalisht se vendi i saj i mëparshëm i punës ishte zënë, pretendim i cili sipas Shoqërisë nuk qëndron, pasi bie poshtë me njoftimin që Administratorja i ka dërguar për t'u paraqitur pranë Shoqërisë, për vazhdimin e marrëdhënies së punës.

Në vijim, "Emante" sh.p.k ka shpjeguar se, znj.K aktualisht rezulton punonjëse pranë kesaj Shoqërie dhe se asaj i është kërkuar vazhdimi i marrëdhënies së punës, megjithëse ankuesja nuk është paraqitur në punë pas përfundimit të lejes së lindjes. Në këtë kontekst Shoqëria parashtron faktin se ankueses i ka kaluar paga në llogarinë bankare personale, si dhe vijojnë t'i paguhen sigurimet shoqërore edhe pse ajo vazhdon të mos paraqitet në punë.

Konkretisht, sipas shkresës së datës 09.10.2020 (Njoftim nr.4) që Shoqëria "Emante" sh.p.k i drejton ankueses, ndër të tjera, thuhet : *"Në vazhdim të komunikimit me ju, ju bëjmë me dije se vazhdoni të jeni në marrëdhënie pune me kompaninë tonë edhe pse vazhdoni të mos paraqiteni në punë. Shoqëria jonë vazhdon të shlyejë detyrimet e saj karshi jush duke ju kaluar edhe pjesën e pagës në llogarinë tuaj bankare si vazhdim i marrëdhënies dhe kontratës së punës që ka me ju"*.

Në përgjigjen e tyre, e cila për dijeni i është dërguar edhe ankueses, Shoqëria informon Komisionerin, njëherësh edhe ankuesen, se kanë kërkuar dhe janë në pritje të qëndrimit të znj.K për të marrë dhe njoftuar vendimin e saj në lidhje me vazhdimin e marrëdhënies së punës me Shoqërinë.

Nëpërmjet komunikimit telefonik ankuesja ka konfirmuar para KMD se nuk pranon të hyjë në bisedime me Shoqërinë për t'u emëruar në një pozicion pune paralel/ekuivalent dhe me të njëjtën pagë me atë që kishte, pasi është shprehur se është ndjerë e diskriminuar prej tyre dhe asaj i është bërë zgjidhje e njëanshme e kontratës së punës.

III. Vlerësimi i Komisionerit, i fakteve dhe provave të grumbulluara, gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe diskriminues të pretenduar nga subjekti ankues.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës dhe në analizë të sa mësipër, rezultoi se:

Marrëdhënia e punës mes ankueses dhe Shoqërisë "Emante" sh.p.k daton që me 12.01.2015. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës, znj.K, për periudhën tetor 2019- 14.09.2020 ka qenë me raport barrë lindjeje, pasi ishte shtatzënë me vajzën e saj. Provohet se subjekti ankues, para marrjes së raportit të barrë lindjes ka mbajtur pozicionin e finances pranë kësaj Shoqërie. Ajo duhet të paraqitej në detyrë me mbarimin e këtij raporti, me datë 14.09.2020. Ankuesja ka pretenduar se është paraqitur por nuk është lejuar të futej në ambjentet e Shoqërisë. Lidhur me këtë fakt, ajo ka vënë në dijeni punëdhënësin nëpërmjet shërbimit postar dhe nga kuponi i dorëzimit rezulton se shkresa është dorëzuar pranë Shoqërisë me datë 23.09.2020. Ndërkohë që ankuesja deklaroi se ishte njoftuar shkresërisht, me datë 21.09.2020,

nga ana e punëdhënësit për të diskutuar mbi kushtet e vazhdimësisë së marrëdhënies së punës, për shkak se nuk ishte paraqitur në punë pas përfundimit të lejes së lindjes.

Me datë 24.09.2020 ankuesja, e ndodhur në kushtet kur ka pretenduar se nuk është lejuar të hynte në ambjentet e punës, ka njoftuar punëdhënësin se ajo kishte konsideruar se kontrata e punës ishte zgjidhur në mënyrë të njëanshme nga ana e Shoqërisë.

Ndërkaq, në vijim, me datë 26.09.2020 ankuesja është njoftuar rishtaz nga Shoqëria se ishte e mirëpritur të paraqitej pranë zyrave të Shoqërisë për të diskutuar lidhur me kushtet dhe vazhdimësinë e marrëdhënies së punës, duke i ofruar mundësinë në një pozicion pune paralel/ekuivalent pranë kësaj Shoqërie.

Bazuar në komunikimin shkresor ndërmjet palëve në proces² rezulton se ata gjatë kësaj periudhe nuk kanë zhvilluar një takim konkret lidhur me bisedimet për vijimin e marrëdhënieve të punës dhe se secila palë pretendimet e veta ia kanë shprehur njëti-tjetrit shkresërisht.

Komisioneri ka vlerësuar pretendimet e ankueses, lidhur me kërkimet e saj pranë KMD-së, përse i takon zgjidhjes së marrëdhënies së punës, ku kërkon shprehimisht: *“Shpërblim të dëmit të shkaktuar ndaj meje duke detyruar Shoqërinë “Emante” sh.p.k të më paguajë pagat si pasojë e mosrespektimit të afatit të njoftimit, procedurës së zgjidhjes së Kontratës së Punës, vjetërsisë në punë dhe lejes së pamarrë, ose në të kundërt dënimin e Shoqërisë me gjobë”*.

Në këtë kontekst, lidhur me sa më sipër, bazuar në shkresat dhe dokumentacionin e depozituar në cilësi prove, rezulton se, subjekti ankues vijon të jetë në marrëdhënie pune me Shoqërinë, pasi asaj i është bërë pagesa për të njëjtin pozicion pune që kishte para marrjes së lejes së barrë lindjes. Po ashtu, Komisioneri ka verifikuar se ankueses rezulton t'i jenë paguar kontributet për sigurimet shoqërore, për periudhën e pretenduar prej saj se i ishte zgjidhur marrëdhënia e punës.

Për rrjedhojë, bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, pretendimi i ankueses për zgjidhje të marrëdhënieve të punës nuk qëndron përse kohë provohet me dokumentacion e kundërta. Nuk ka një akt shkresor nëpërmjet të cilit ankueses t'i jetë komunikuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës apo e atyre financiare me Shoqërinë. Në këto rrethana nuk mund të shqyrtohet pretendimi i saj për ndërprerje të kontratës së punës, dhe për më tepër kërkitimi saj që, Shoqëria “Emante” sh.p.k t'i paguajë pagat si pasojë e mosrespektimit të afatit të njoftimit, procedurës së zgjidhjes së Kontratës së Punës, etj.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të*

² Shkresë e subjektit ankues drejtuar Shoqërisë, me datë 01.10.2020.

Shkresë e subjektit ankues drejtuar Shoqërisë, me datë 02.10.2020.

Shkresë e Shoqërisë drejtuar ankueses: “Njoftim” nr. 3, datë 05.10.2020.

Shkresë e subjektit ankues drejtuar Shoqërisë, me datë 07.10.2020.

Shkresë e Shoqërisë drejtuar ankueses: “Njoftim” nr. 4, datë 09.10.2020.

njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Bazuar në përgjigjen shkresore dhe dokumentacionin bashkëlidhur, gjykojmë se fakti për të cilin ankuesja ka pretenduar diskriminim, ai i zgjidhjes së kontratës së punës nga ana e Shoqërisë, nuk ekziston, përkundrazi, ka një vullnet konstant të Shoqërisë për vazhdimin e marrëdhënieve të punës me ankuesen pa çënua as profesionin, as pagën e kësaj të fundit. Për rrjedhojë dhe pretendimi për diskriminim për këtë fakt nuk qëndron dhe është i pabazuar në prova.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se nga ana e Shoqërisë, nuk janë ndërmarrë veprime që që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi diskriminues përsa i takon pretendimeve që lidhen me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me të.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Shoqërisë “Emante” sh.p.k, për shkakqet e pretenduara nga F. K.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1/c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të F. K, për shkaqet e pretenduara, nga ana e Shoqërisë “Emante” sh.p.k.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Punësim

Shkaku: Shtatzënia, barrë lindja

Lloji i vendimit: Konstatim mosdiskriminimi